



20

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KUVENDI
Komisioni i Çështjeve Kushtetuese dhe Ligjeve

R E L A C I O N

Per dekretin e Presidentit nr. 4253, date 02.07.2004
“Per kthimin e ligjit nr. 9235, date 08.06.2006
“Per kthimin dhe kompensimin e prones”

Komisioni i Ceshtjeve Kushtetuese dhe Ligjeve, ne mbledhjen e dates 20.07.2004, mori ne shqyrtim dekretin e Presidentit “Per kthimin e ligjit “Per kthimin dhe kompensimin e prones”.

Ne mbledhje mori pjese keshilltari juridik i Presidentit, i cili parashtroi motivet e kthimit te ligjit “Per kthimin dhe kompensimin e prones”, motive te cilat konsistojne ne nje rishikim te disa pjeseve te ligjit qe sipas argumenteve te dhena nuk jane te rregulluara ne menyre te plote dhe krijojne konflikte te panevojshme si rezultat te interpretimeve te ndryshme qe mund t’i behen.

Komisioni i Ceshtjeve Kushtetuese dhe Ligjeve, pas diskutimeve te shumta, ne mbeshtetje te nenit 85, pika 2 te Kushtetutes, me shumice votash vendosi qe te pranoje dekretin e Presidentit “Per kthimin e ligjit “Per kthimin dhe kompensimin e prones”.

Spartak BRAHO

KRYETAR





REPUBLIKA E SHQIPERISE
KUVENDI
Komisioni i Çështjeve Kushtetuese dhe Ligjeve

RELACION

Per dekretin e Presidentit nr. 4253, date 02.07.2004
“Per kthimin e ligjit nr. 9235, date 08.06.2006
“Per kthimin dhe kompensimin e prones”

Komisioni i Cështjeve Kushtetuese dhe Ligjeve, ne mbledhjen e dates 26.07.2004, mori ne shqyrtim dekretin e Presidentit “Per kthimin e ligjit “Per kthimin dhe kompensimin e prones”.

Komisioni u njoh me propozimet e Grupit Parlamentar te Partise Socialiste per te reflektuar ne ligjin “Per kthimin dhe kompensimin e prones” disa nga verejtjet e bera nga Presidenti.

Megjithate ne kete mbledhje Komisioni nuk mori vendim per t’i lene kohe grupeve politike per te arritur konsensus.

Komisioni i Cështjeve Kushtetuese dhe Ligjeve, ne mbledhjen e zhvilluar ne daten 27 korrik, u njoh me relacionin e Komisionit te Ekonomise dhe Financave dhe me formulimet e bera per disa shtesa dhe ndryshime ne ligj.

Me shumice votash, Komisioni i Ligjeve mbeshtet relacionin e Komisionit te Ekonomise dhe Financave lidhur me formulimet qe nuk duhen ndryshuar ne ligj si dhe me shtesen e bere ne nenin 15 per rastet e shkarkimit te anetarit te Komitetit Shteteror per Kthimin dhe Kompensimin e Pronave. Komisioni mbeshtet edhe verejtjen e bere ne nenin 8 te ligjit.

Spartak BRAHO

KRYETAR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni i Bujqësisë dhe Ushqimit

RELACION
 për
**Dekretin e Presidentit “Për kthimin e Ligjit Nr. 9235, datë
 8.6.2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronës””.**

Komisioni i Bujqësisë dhe i Ushqimit shqyrtoi dekretin në fjalë si dhe disa propozime të grupeve parlamentare për çështjen e pronave, në mbledhjen e datës 26.7.2004.

Në diskutimet e anëtarëve të komisionit u theksua se propozimet alternative të grupeve parlamentare janë të diferencuara dhe për to nuk mund të arrihet një konsensus.

Komisioni i Bujqësisë dhe Ushqimit është shprehur një herë dhe ka mbajtur një qëndrim i cili nuk ndryshon as tani.

Si përfundim, komisioni çmon se i takon seancës plenare të vendosë se çfarë qëndrimi do të mbajë për propozimet e paraqitura në Dekretin e Presidentit të Republikës, apo edhe për amendamente të ndryshme të grupeve parlamentare.

KRYETARI

Jemin GJANA

Tiranë më 26.7.2004



REPUBLICA E SHQIPERISE
KUVENDI
Komisioni i Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit

RAPORT
PËR
DEKRETIN E PRESIDENTIT NR. 4253, DATË 2.07.2004 "PËR KTHIMIN E
LIGJIT NR. 9935, DATË 8.06.2004
"PËR KTHIMIN DHE KOMPESIMIN E PRONËS"

Komisioni i Ekonomisë në mbledhjen e datës 26.07.2004 shqyrtoi Dekretin e Presidentit nr. 4253, datë 2.07.2004 "Për kthimin e ligjit nr. 9935, datë 8.06.2004 "Për kthimin dhe kompesimin e pronës".

Pas shqyrtimit të dekretit të Presidentit për kthimin e ligjit nr. 9935, datë 8.06.2004 "Për kthimin dhe kompesimin e pronës", Komisioni i Ekonomisë me shumicë votash ra dakord, që në ligjin nr. 9935, datë 8.06.2004 "Për kthimin dhe kompesimin e pronës", të bëhen këto ndryshime:

Në lidhje me kompetencën dhënë Komitetit Shtetëror për Kthimin dhe kompesimin e pronës në nenin 16, pika 1/a për shfuqizimin e vendimeve të komisioneve vendore Komisioni i Ekonomisë është i mendimit që formulimi i bërë në ligj të mbetet, sepse kemi të bëjmë me një kompetencë të domosdoshme që duhet ta ketë një organ superior siç është KSHKKP.

Në lidhje me të drejtën e Komitetit Shtetëror dhënë në nenin 16, pika 2 komisioni i Ekonomisë është i mendimit se formulimi i bërë në këtë pikë nuk bie ndesh me ligjet në fuqi, kjo e drejtë i duhet dhënë KSHKKP duke patur parasysh rastet abuzive dhe në kundërshtim me ligjet në fuqi. Kjo e drejtë është e kullizuar në kohë dhe vetëm kur kërkohet nga organet e pushtetit vendor dhe subjektet e shpronësuar. Në rastet e praktikave që kanë përfunduar me titull pronësie të hipotekuar do të jetë vetëm procesi gjyqësor që mund të marr vendimin përfundimtar. Me gjithatë Komisioni i Ekonomisë sugjeron që kjo e drejtë mund të ridimensionohet dhe të mbetet vetëm për rastet që lidhen me zbatimin e ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 "Për kthimin dhe kompesimin e pronave ish-pronarëve". Pra në pikën 2 të nenit 16 të hiqen fjalët: "dhe vendimet administrative të dhëna për ndarjen e tokës bujqësore sipas ligjit nr.7501 datë 19.7.1991 "Për tokën" dhe ndarjen e tokave bujqësore të ish-ndërrmarjeve bujqësore"

Gjithashtu në mënyrë që kjo e drejtë të zbatohet vetëm në rastin e ankimimit, Komisioni i Ekonomisë propozon që pika 4 a) e nenit 16 të hiqet.

Neni 8, pika 4, rreshti i dytë fjalët: "qira ose", hiqen.

Neni 15, pas pikës 4, shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:


“5. Anëtari i Komitetit Shtetëror për Kthimin dhe Kompesimin e Pronave shkarkohen me vendim të Kuvendit të Shqipërisë kur:

- a) Me vendim gjykatë të formës së prerë është dënuar për një vepër penale dhe ose është ndaluar ose pezulluar të ushtrojë detyrën si nëpunës publik;
- b) Është në pamundësi fizike dhe mendore për të ushtruar funksionin e vetë me raport mjekoligjor apo me vendim gjykatë;
- c) mungon katër ose më shumë herë radhazi në mbledhjet e Komitetit Shtetëror për Kthimin dhe Kompesimin e Pronave, pa shkaqe të arësyeshme;
- d) vërtetohet se ka siguruar përfitime të padrejta, që lidhen me ushtrimin e kompetencave të tij;
- e) shkel nenet e këtij ligji.

Asnjë anëtar i Komitetit Shtetëror për Kthimin dhe Kompesimin e Pronave nuk mund të shkarkohet nga detyra për shkaqe dhe procedura të tjera të përmendura në këtë pikë, me përjashtim të rastit kur ai jep dorëheqjen.”

Për çështje të tjera që lidhen me formulën e përbërjes së Komitetit dhe komisioneve vendore, Komisioni i Ekonomisë gjykon se ato mund të jenë produkt i marrëveshjeve midis grupeve parlamentare.

**KRYETARI I KOMISIONIT
Ylli BUFI**



Tiranë më 26.07.2004